



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE BURIMEVE NJERËZORE

Lënda: Njoftim në shtyp për vend të lirë pune

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në kuadër të projektit “**Masat multidisiplinare për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimi i punës dhe migrimi i pasigurtë**” mbështetur nga prezenca e OSBE në Shqipëri, Bashkia e Tiranës shpall konkursin për plotësimin e stafit menaxhues të projektit me pozicionin si më poshtë:

1.Këshilltar dhe Koordinator për Mbrojtjen e Fëmijëve

Kushtet e Punësimit

Kandidatët e përzgjedhur punësohen me kontratë për periudhën 01.09.2018 – 31.12.2018 me mundësi ripërsëritje të saj.

1.Këshilltari dhe Koordinatori për Mbrojtjen e Fëmijëve, garanton mirëfunksionimin e sistemit të administrimit dhe koordinimit të projektit dhe bashkërendimin e punës gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të tij. Koordinon, lehtëson komunikimin dhe mban kontakte të ngushta me të gjithë përfituesit finalë dhe strukturat e ngritura për menaxhimin e projektit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore:

-Mbështetje teknike të vazhdueshme për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve, për fuqizimin e kapaciteteve të tyre në punën me fëmijët në rrezik apo viktime të abuzimit, shfrytëzimit, dhe fëmijët në situatë rruge.

-Mbështetje teknike dhe siguron koordinimin e skuadrave të terrenit që punojnë për identifikimin dhe referimin e fëmijëve, subjekt i shfrytëzimit, abuzimit, përfshirë fëmijët në situatë rruge në Bashkinë e Tiranës.

-Mbështetje teknike dhe koordinimin e punës së Grupit Ndërsektorial Teknik, në Bashkinë e Tiranës dhe /apo në nivel të Njësive Administrative, për identifikimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e rasteve të fëmijëve në situatë rreziku apo nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

-Siguron dhe monitoron plotësimin e të dhenavënë-databasën, për situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me fokus të vecantë fëmijët në situatë rruge.

-Kontribuon në zhvillimin e mjeteve të punës për të siguruar zbatimin cilësor të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, për profesionistët në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, në veçanti fëmijët në nevojë për mbrojtje.

-Koordinon dhe siguron mbarvajtjen e marrdhenieve të bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Prezencës së OSBE në kuadër të zbatimit të projektit, dhe aktorët e tjerë përgjegjës në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve etj.

Kandidatët duhet të jenë të kualifikuar sipas specifikimeve të mëposhtme:

Kriteret e veçanta:

- Diplomë në Master Shkencor (Msc) në Shkenca Sociale, dega Pune Sociale
- Përvojë pune të paktën 5 vjetare me menaxhimin e projekteve ndërkombëtare;
- Gjuhën Anglisht të rrjedhshme në të folur dhe në të shkruar; Preferohet njohja edhe e gjuhës Italiane;
- Aftësi të shkëlqyera në përdorimin e kompjuterit për sa i përket MS Office, Exel, Poëer Point, Internet.

Të preferushme

- Eksperiencë në team leading;
- Njohuri të mira në menaxhimin e projektit ;
- Përvoja të ngjashme në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve të BE-së, dhe/ose ndërkombëtare;
- Eksperiencë dhe përshtatshmëri për të punuar në planin ndërkombëtar me aftësi të ndryshme administrative;
- Komunikues, bashkëpunues dhe me dëshirën për të punuar në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i aplikantit
- b-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c-Fotokopje të noterizuar diplomës
- d-Fotokopje të noterizuar të listës së notave
- e-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g-Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- h-Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
- i-Dokumenti për master, doktoraturë (në rast se ka), fotokopje e noterizuar
- j-Dëshmi të gjuhëve të huaja.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës 25.09.2018

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit datën, vendin dhe orën e zhvillimit të testimit.

Testimi do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë së Tiranës.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia e Tiranës do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe stendat e informimit të publikut të Bashkisë së Tiranës.